



№. Prot. 76/12025
D. P. Prot. 2107/2025

UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA"
" Zija Shemsiu pn., 60000, Gjiilan, Republika e
Kosovës www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

RAPORT
I KOMISIONIT VLERËSUES PËR ZGJEDHJEN E STAFIT AKADEMIK ME
ANGAZHM NE SEMESTRIN VEROR, 2024/2025
NJË (1) ASISTENT - E DREJTA FNANCIARE TE FAKULTETIT JURIDIK

24/02/2025

Gjiilan

Përmbajtja

Shqyrtimi i dosjeve të kandidateve të paraqitur në konkursin publik të shpallur për (1 asistent) në lëndet ekonomike - Fakultetit Juridik UKZ.

I përpiluar më 24 Shkurt 2025, me rastin e intervistimit të kandidatëve për bashkëpunëtor/asistent për mbajtjen e ushtrimeve, **neni 6. par.3. nën paragrafi . 3.5.** të Rregullores mbi procedurat e angazhimit të bashkëpunëtorëve të jashtëm – me honorar, të paraqitur në konkursin, e shpallur nga Universiteti “Kadri Zeka, Ref.nr.01/199 të datës 17/02/2025, për një pozitë “Asistent të angazhuar-honorar “ për fushën Ekonomike.

Intervistimi i kandidateve nga Komisioni Vlerësues i Fakultetit Juridik, në Universitetin Publik “Kadri Zeka” Gjilan nga Fusha Ekonomike, 1 asistent me angazhim:

Data: 21/02/2025

Ora: 11:00 – 12:00, UKZ

Pjesëmarrës në këtë mbledhje/intervistim, ishin:

1. Prof.ass.Dr.Valbona Zeqiraj -Kryetare
2. Prof.asoc.Dr. Fadil Osmani - Anëtar
3. Prof.asoc.Dr. Albulena Hajdari Krasniqi-Anëtare

Nga ana e Kryetares së Komisionit Vlerësues konstatohet prezenca e anëtarëve pjesëmarrës në këtë komision. Konstatohet dosja e kandidatëve të paraqitur në Konkurs për angazhimin e personelit akademik, në njësinë akademike të Universitetit Publik “Kadri Zeka” Gjilan Ref.nr. **01/199 dt.17/02/2025**, për vitin akademik 2024/2025.

Konstatohet se asnjë nga anëtarët e Komisionit Vlerësues nuk ka konflikt potencial të interesit në vlerësimin e kandidatëve.

Kandidatët i kanë paraqitur dokumentacionin për pozitën: një (1) asistent/e, për semestrin veror në lëndet nga fusha Ekonomike, siç janë: Praktika profesionale (0), E drejta financiare (0) Integrimet ekonomike evropiane (0).

Lista e kandidateve të paraqitur në Konkurs, janë:

1. Lirim Xhimi
2. Merita Kciku
3. Hysni Terziu

Konstatohet se gjatë intervistimit asnjë nga kandidatët nuk ka shprehur se ka vërejtje në përbërjen e Komisionit Vlerësues.

1. Pas shqyrtimit të dosjes nga ana e komisionit komisioni konstaton se kandidati **Lirim Xhimi** nuk është i fushës dhe si i till nuk i plotëson kushtet formale juridike andaj nuk propozohet për asistent. .

2. **Kandidati Dr. Sc. HYSNI TERZIU**, i lindur më **22.06.1957** nuk propozohet për asistent në asnjërën nga lëndët e shpallura në konkursin e datës 17/02/2025 sepse ai ka arritur moshën e pensionimit.

Duke marrë parasysh që Ligji Nr. 03/L-212 i Punës gëzon epërsi në raport me të gjitha aktet juridike nënligjore, ne si komision jemi të detyruar të zbatojmë këtë ligj.

Përkatësisht, ky vendim është marrë në bazë të normës imperative (të detyrueshme) të Nenit 67 të këtij ligji, më të cilën dispozitë rregullohet çështja e ndërprerjes së kontratës së punës sipas fuqisë ligjore, ku theksohet se: **Kontrata e Punës sipas fuqisë ligjore, ndërpritet: 1.4. kur i punësuari e mbush moshën e pensionimit, prej gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç;**

Sipas Nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1. ****Kontrata e Punës është: akti individual e cila lidhet ndërmjet punëdhënësit dhe të punësuarit,* me të cilën rregullohen të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga marrëdhënia e punës në pajtim me këtë ligj, me Kontratën Kolektive dhe me Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit.***

Meqenëse, sipas fuqisë së ligjit është e detyruar që kontrata e punës të ndërpritet në momentin kur personi mbush moshën 65 vjeçare, kjo nënkupton që asnjë kontratë e re e punës nuk mund të lidhet me personin i cili ka arritur moshën e pensionimit, andaj komisioni recensues vendosi si më lart, pasi që UKZ nuk mund të lidhë kontratë të kundërligjshme me kandidatin.

Ky kandidat nuk propozohet nga Komisioni Recensues, sespe Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik i vitit 2023 është i detyrueshëm të zbatohet, më saktësisht ne si komision iu kemi referuar: Nenit 5, paragrafi 4 dhe Nenit 77 paragrafi 1 të këtij ligji.

3. **Kandidatja Merita Kergeli** i plotëson kushtet formalo-juridike për zgjedhjen e asistentit të angazhuar, për arsye se kandidatja ka dorëzuar dokumentacionin e kompletuar sipas konkursit të shpallur nga UKZ, për zgjedhjen e asistentit të angazhuar në njësinë akademike të Fakultetit Juridik të Universitetit “Kadri Zeka” Gjilan për semestrin veror të vitit akademik 2024/25, ku kandidatja: Posedon dosjen e kompletuar në bazë të Konkursit.

Gjithashtu, gjatë intervistimit, kandidatja ka pasur performancë të lartë në paraqitje dhe premtion shumë që do i jep përkrahje institucionit dhe vetë studenteve.

Prandaj, nga të thënat si më lartë dhe në bazë të dispozitave ligjore në fuqi Komisioni Recensues lidhur me pozitën e hapur në bazë të konkursit për (1) një asistent me angazhim, merr këtë:

VENDIM

Kandidatja Merita Kergeli, i propozohet Këshillit të Fakultetit, për pozitën: **asistent i angazhuar** në lëndet ekonomike - Fakultetin Juridik UKZ

Komisioni erdhi deri të ky propozim duke pasur për parasysh se e njëjta i plotëson të gjithë kushtet e parapara në Statutin, Rregulloren për zgjedhjen e personelit akademik- **asistent i angazhuar**, si dhe kriteret e specifikuar në konkursin e shpallur të Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjilan.

1. Prof.Ass.Dr.Valbona Zeqiraj- Kryetare : _____

2. Prof.Asoc.Dr.Fadil Osmani – Anëtar: _____

3. Prof.Asoc.Dr.Albulena Hajdari-Krasniqi- Anëtare: _____

KËSHILLA JURIDIKE: kandidatët e pakënaqur me Raportin e Komisionit Vlerësuese, kanë

të drejtë ankese pranë Komisionit të Ankesave në Fakultetin Juridik, në afat prej 3 ditëve nga data e publikimit të të njejtit.

Data:24/02/2025